



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore për nevojat buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për vitin 2019.
2. Seancë dëgjimore për nevojat buxhetore të Gardës së Republikës për vitin 2019.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Elona Hoxha, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu, Antoneta Dhima dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Paulin Sterkaj, Myslim Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Braimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çela.

Të ftuar:

Stefan Çipa - Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Mirjana Zisi - Drejtoreshë e Financave

Bardhul Kaçori - Drejtor i Policisë së Burgjeve

Avidana Pali - Përgjegjëse e Sektorit të Financës

Gramos Sako - Komandanti i Gardës së Republikës

Astrit Osmani - Shef Sektori i Financës dhe Buxhetit

Hysen Minxhozi - Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse në Gardën e Republikës

Valion Cenalia - Specialist në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave

Renald Petruti - Specialist në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi parashikuar dy seanca dëgjimore.

Së pari, kemi seancën dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për të kuptuar nëse parashihmi i buxhetit për vitin 2019 përputhet me planet e organizmit dhe të funksionimit në përgjithësi në sistemin e burgjeve.

Së dyti, do të kemi një seancë dëgjimore me të njëjtin objekt, por që lidhet me Gardën e Republikës.

Për pikën e parë të rendit të ditës kemi të ftuar drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, zotin Stefan Çipa.

Zoti Çipa, meqenëse jeni për herë të parë në këtë detyrë, sepse në këtë komision ju keni qenë edhe më herët, ju uroj suksese në punën tuaj.

Gjithashtu kemi të ftuar zonjën Mirjana Zisi, drejtoreshë e Financave, zotin Bardhul Kaçori, drejtor i Policisë së Burgjeve, si dhe zonjën Avidana Pali, përgjegjëse e Sektorit të Financës, të cilëve u uroj mirëseardhjen dhe suksese në punën e tyre!

Në të dyja seancat dëgjimore do të kemi prezent edhe dy specialistë të Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave, zotin Valion Cenalia dhe zotin Renald Petrit.

Në këtë seancë dëgjimore ne jemi të fokusuar të dëgjojmë planet tuaja të punës, të kuptojmë nëse ato përputhen me parashikimin e buxhetit të vitit 2019, si dhe nëse ka nevojë që ky komision parlamentar të nxisë më tej Ministrinë e Financave për të plotësuar më mirë nevojat tuaja buxhetore. Pa diskutim, ne jemi të hapur sikundër për të gjitha institucionet e sigurisë që kanë ardhur në këtë komision që t'ju mbështesim. Relator në këtë dëgjese nuk kemi dhe natyrisht nuk kemi as votim, por ideja është që ju të dëgjoheni.

Faleminderit!

Fjala është për ju, zoti Çipa.

Stefan Çipa – Faleminderit, zonja kryetare!

Zotërinj deputetë të Komisionit të Sigurisë,

Së pari, dua t'ju falënderoj për rëndësinë që i kushtoni sistemin penitenciar në Shqipëri, duke na thirrur në këtë komision si një institucion i rëndësishëm i sigurisë kombëtare! Si fillim

dua të them se sistemi i burgjeve në Shqipëri është lënë pak pas dore dhe është parë thjesht si një plaçkë zgjedhore, duke u bërë qoka e partive.

Sistemi i burgjeve në Shqipëri duhet trajtuar si një sistem i grupit të parë me një ligj organik të veçantë, të paktën të barazohet me drejtoritë e tjera, siç është Policia e Shtetit. Në vitin 2018 është treguar një kujdes i veçantë dhe investimet që janë bërë janë të një rëndësie të veçantë, siç është investimi kryesor i bërë në muajin gusht, i cili ka përfunduar, burgu i Reçit në Shkodër me një kapacitet 780 vende, 600 janë të dënuar dhe 180 të paraburgosur, ku për herë të parë e ka nxjerrë sistemin e burgjeve nga mbipopullimi. Mund të ketë mbipopullim në ndonjë burg tjetër, por me funksionim i këtij burgu ne jemi duke marrë në dorëzim burgun e ri “Jordan Misja”, 313 është drejt përfundimit një investim i qeverisë me vlerë 575 milionë lekë. Në të dyja këto burgje u është kushtuar rëndësi, pasi ne e dimë se si k i kemi burgjet apo I EVP-të në të gjithë Shqipërinë. Gjatë këtij viti janë bërë katër rikonstruksione të burgjeve, siç është spitali i burgut, që kishte që nga viti 1936 dhe ishte një godinë e vjetër. Në këtë spital ishte bërë një rikonstruksion në vitin 2009 dhe tani me një investim me 30 milionë lekë merr realisht formën e një spitali, duke e rikonstruktuar tërësisht disa pavijone, siç është reanimacioni, pavijoni i patologjisë.

Së dyti, është rikonstruktuar I EVP-ja e Burrelit, i cili ishte një I EVP shumë e vjetër që nga viti 1934 që është ndërtuar dhe kishte vite pa u trajtuar. Gjithashtu është bërë rikonstruksion në burgun e sigurisë së lartë të Peqinit dhe përshtatjen e dy godinat e burgut të Lezhës për t’i kthyer në spital për të trajtuar të sëmurët që janë me mjekim të detyrueshëm, duke plotësuar edhe normat për të drejtat e të dënuarave, duke i trajtuar në bazë të parametrave. Ne jemi organizatë që monitorohemi edhe nga të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe janë një sërë standardesh që ne duhet t’i plotësojmë.

Gjithashtu, pas një dekade në Policinë e Burgjeve ne po presim edhe uniformat e punonjësve të policisë së burgjeve rreth 3000 mijë uniforma dhe për vitin që vjen janë parashikuar 140 milionë lekët të rinj dhe ne plotësojmë totalisht për të qenë një polici dinjitoze dhe Policia e Burgjeve, të paktën të jetë e përafërt me Policinë e Shtetit.

Me interesimin e ministres së Drejtësisë dhe Kryeministrit ne kemi marrë një fond për ndërtimin e një salle operative për garantimin e sigurisë për bllokimin e aparateve të celularëve në burgjet e sigurisë së lartë. Kuptohet se do të kemi akses në të gjitha kamerat në burgje, të cilat do të monitorohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Këto janë pak a shumë çfarë janë bërë në një vit, sepse kishte shumë vjet që Policia e Burgjeve nuk ishte trajtuar, që nga viti 2009 apo 2010.

Ne jemi thirrur këtu për nevojat që kemi për buxhetin e vitit 2019. Në buxhetin e vitit 2018 ne kemi pasur një fond prej 5,7 miliardë lekësh të detajuara në shpenzimet kapitale, shpenzime operative dhe shpenzime personeli. Për vitin 2019 fondi është rreth 5,8 miliardë lekë, por po t'i analizojmë zë për zë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, ka kërkuar të ketë një shtim në organikë prej 216 punonjësish, duke hequr pjesën e shërbimit të brendshëm, që tashmë varet nga Ministria e Drejtësisë. Këta 216 punonjës i kemi kërkuar për sallën operative, sepse është e domosdoshme, ndërsa 120 punonjës policie do të jenë për vënien në funksion të paraburgimit të “Jordan Misja”. Ky është një paraburgim i ri, i cili do të fillojë të funksionojë ndoshta muajin e ardhshëm, por me kapacitet të plotë do të fillojë vitin e ardhshëm.

Gjithashtu, ne kemi nevojë për 7 mjekë dhe 25 mirëmbajtës në çdo IEVP. Faktikisht, kjo është e paargumentuar nga Ministria e Financave kur është akorduar me Ministrinë e Drejtësisë, sepse janë miratuar 71 punonjës shtesë, duke lënë si problem këta 120 punonjës, të cilët do të punojnë të “Jordan Misja” dhe 25 të mirëmbajtja. Pra, për këta 120 punonjës shtesë duhet një fond për pagat bazë rreth 36 milionë lekë.

Një rëndësi të veçantë ka edhe unifikimi i pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve, që minimalisht të jetë sa punonjësit e Policisë së Shtetit. Policia e Burgjeve, për vetë vështirësinë që ka, është më e avancuar se Policia e Shteti. Fatkeqësisht gjithë këto vjet Policia e Burgjeve është lënë pas dore dhe trajtohet më keq në krahasim me policinë e tjera, prandaj lind si domosdoshmëri unifikimi i pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve me Policinë e Shtetit. Nga një fond kontigjence për Drejtorinë e Burgjeve është bërë një shtesë prej 177 milionë lekësh, që është 7%, duke lënë pa mbuluar pjesën më të madhe. Kjo do të ishte shumë e domosdoshme, sepse ligji organik për Policinë e Burgjeve thotë se pagat për grada dhe pagat për funksion në Policinë e Burgjeve duhet të trajtohen njëjloj si Policia e Shtetit.

Së dyti, numri i mjekëve që shërbejnë në burgje është i pakët dhe janë të keqpaguar. Pra, këta mjekë trajtohen me kategorinë IVb aq sa një specialist i nivelit bazë, prandaj nuk vjen të punojë asnjë mjek. Ky është shqetësim kryesor, sepse, pavarësisht investimeve që bëjmë në burgje, mjekët nuk kanë interes të punojnë në burgje, madje edhe ata që janë po largohen. Gjithashtu, edhe pse po bëhen investime në spitale për të pasur kujdesin shëndetësor me këto paga mund të vijnë të punojnë vetëm pensionistët. Kështu që shtesa e pagës për mjekët që punojnë në spitalet e burgjeve duhet të jetë sa një mjek që punon në zona të vështira, sepse realisht punojnë në kushte

të vështira, ndaj kjo pjesë duhet riparë me shumë kujdes. Gjithashtu, është shumë e domosdoshme dhe ne kërkojmë që të bëhen këto shtesa minimalisht për t'i vendosur në punë Burgun 313.

Këtu kemi edhe një problem të mbartur prej dy vjetësh, sepse numri i punonjësve në strukturën e Policisë së Burgjeve është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave të vitit 2017 dhe për dy vjet ne nuk kemi asnjë numër mjekësh specializantë. Realisht nuk ka pasur fond dhe struktura në numrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk është përmirësuar.

Këto kisha për fondin e pagave dhe janë çështje më të domosdoshme që ne kemi nevojë për mbështetje nga Komisioni i Sigurisë, nga Komisioni i Ekonomisë, si dhe nga Ministria e Financave, sepse është gjëja kryesore për funksionimin normal të këtyre investimeve.

Lidhur me nevojat operative, kërkesa ka qenë 1 miliard e 500 milionë lekë dhe unë do të kisha dëshirë që ky fond të rritej. Duke qenë se edhe zoti Qefalia vjen direkt nga sistemi i burgjeve, pasi ka qenë drejtues atje, mund të na mbështeste dhe mendoj se mendimi i tij do të ishte një votë e shtuar për ne.

Ne jemi të detyruar t'i marrim parasysht disa shpenzime, pasi nuk mund të luajmë me shpenzimet që kanë të bëjnë me trajtimin ushqimor të dënuarve, me uniformat e policisë, me pagesat për medikamente, të cilat janë të limituara. Këtu mbeten pa u mbuluar rreth 150 milionë lekë, që janë detyrime që ne kemi me të tretët si rezultat i fitimit të gjyqeve, si dhe pagesa që ne duhet t'u bëjmë punonjësve që dalin në lirim dhe vazhdojnë ecurinë, e cila është në vlerën rreth 40 milionë lekë.

Lidhur me investimet kapitale, ne kërkojmë një shumë rreth 387 milionë e 969 mijë lekë. Realisht ne kemi kërkuar rreth 492 milionë lekë dhe i kemi specifikuar, krahas investimeve të domosdoshme, për sistemin e flotës, e cila është e amortizuar, për mjetet e transportin që ne kërkojmë dhe i kemi planifikuar për këtë vit. Ne kemi planifikuar investime të domosdoshme në disa IEVP si në Tepelenë, Rrogozhinë, Lushnjë, Krujë, si dhe në IEVP-në që ndodhet tek "Ali Demi", sepse kanë vite pa u rikonstruktuar. Ne kemi kërkuar rreth 300 milionë lekë për këto investime për të bërë disa riparime, sepse nuk bëhet fjalë për investime të reja, në mënyrë që këto burgje të kthehen në normalitet dhe me parametrat që të funksionojnë realisht. Këto ishin shkurtimisht ato që ne kërkojmë.

Gjithashtu, ne ju kemi sjellë një informacion më të detajuar dhe kërkojmë mbështetjen e Komisionit të Sigurisë për vetë rëndësinë që ka sistemi penitenciar në Shqipëri, por edhe si

institucion i rëndësishëm për rëndësinë kombëtare, që vëmendja juaj të jetë në mbështetjen e këtyre fondeve, sidomos për pikën e parë lidhur me fondin e pagave.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Çipa!

Nuk e di nëse zoti Kaçori kërkon të ndërhyjë në këtë pikë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull!

Faleminderit për prezantimin!

Natyrisht, ju keni përgatitur një material shumë të hollësishëm lidhur me nevojat tuaja dhe besoj se ky do t'u shërbejë të gjithë kolegëve deputetë për t'u orientuar sa më mirë.

Sidoqoftë, unë po hap diskutimin dhe, sikundër premtova, do t'i jap fjalën zotit Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë dua të sjell në vëmendje të drejtorit të Përgjithshëm dhe të gjithë stafit të Drejtorisë që Komisioni i Sigurisë, falë edhe nismës personale të kryetares, u bë tashmë në vitin e dytë që i jep një suport të veçantë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Po të kthehemi pas në kohë, rreth një vit më parë, kur diskutuam buxhetin e vitit 2018, u desh ndërhyrja e këtij komisioni që të akordohej një fond për uniformat e policëve.

Unë e dëgjova zotin Çipa lidhur me anën e tij profesionale dhe seriozitetin e punës në institucionin që ai drejton. Madje më vjen mirë që ardhja e tij nga detyra e zëvendësministrit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve e kupton se sa e nevojshme edhe e domosdoshme është nevoja për rritjen e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve.

Më lejoni, zoti Çipa, dhe ju anëtarë të komisionit, të sjell në vëmendje që rritja e pagës së punonjësve të policisë ka ndodhur pikërisht kur në Ministrinë e Brendshme ishin në detyrë zëvendësministrat zonja Gjebrea dhe zoti Çipa, sepse në kohën kur ka drejtuar si ministër nuk besoj se ka pasur këtë mundësi dhe këtë akses.

Gjithsesi, pa u larguar te vëmendja dhe domosdoshmëria e punonjësve të Policisë së Burgjeve më lejoni, të nderuar kolegë, të sjell në vëmendjen tuaj që një punonjës i Policisë së Burgjeve në 21 vjet punë që bën në këto institucione 1/3-ën e kohës e kalon në burg, domethënë kryen “dënim” njëlloj si një i dënuar, i cili është akuzuar për një vepër penale. Kështu që absolutisht jam në mbështetje të kësaj kategorie. Gjithashtu, e mbështes këtë kategori edhe për një fakt tjetër, sepse ne jemi koshientë dhe dëshmitarë që nëse do të bënim një anketim midis të rinjve

dhe të rejave për t'i punësuar në institucione shtetërore, numri më i vogël që do të pranojnë për të punuar në burgje do të ketë pikërisht kontingjenti që do të afrohet te burgjet, për të mos thënë se te burgjet punojnë ata individë që nuk arrijnë dot të futen në institucione të tjera. Kështu që këtu kërkohet një domosdoshmëri për mbështetje totale për të rritur pagën e punonjësve të policisë, madje për të vendosur sistemin e karrierës dhe të gradave, të cilat stonojnë shumë nga Policia e Shtetit dhe nga Ministria e Mbrojtjes.

Për atë që sa unë janë në dijeni, bashkë me zotin Braho, sepse kemi qenë paraprakisht në Komisionin e Ligjeve, ku Kryeministri Rama personalisht ka premtuar rritjen e pagave për punonjësit e policisë, e cila do të fillojë në datën 1 prill, kjo nuk do të thotë që 1 prilli është ditë gënjeshtër, sepse në politikanët kemi edhe një përvojë shumë të mirë, nëse ju kujtohet, kemi bërë një marrëveshje në Shkodër. Gjithsesi po e jap këtë njoftim edhe për anëtarët e tjerë të komisionit që rritja e rrogave të punonjësve të policisë së burgjeve do të bëhet realitet pasi është dakordësuar edhe me Ministrinë e Financave dhe ky është një ogur i mirë.

Për sa u përket problemeve të tjera, unë nuk marr atributet e kolegëve pasi ata kanë informacionin dhe mendimin e tyre.

Por, sidoqoftë, zonja kryetare, ju falënderoj për mundësinë që më dhatë për ta thënë këtë gjë dhe shpresoj që institucioni penetenciar këtu në Shqipëri, krahas detyrave të ruajtjes, të kthejë sytë dhe vëmendjen te pjesa e trajtimit human të këtyre individëve, për atë kohë sa u është privuar liria. Organizatat ndërkombëtare dhe kryesisht QPT-ja, janë organizma të cilat penalizojnë shtetin nëse do të ketë shkelje të të drejtave të njeriut.

Për ta mbyllur, mendoj që do të ishte mirë që në këtë takim të ishte edhe Drejtoria e Shërbimit të Provës, pasi këta individë, pavarësisht kryerjes së dënimit të dhënë nga gjykata, shumë shpejt do t'i bashkohen shoqërisë dhe një kooperim i mirë mes institucionit penetenciar dhe institucioneve të tjera të pushtetit vendor apo Shërbimit të Provës do ta përmbushte më mirë misionin që ka vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Fjala është për zotin Ndreu.

Pjerin Nderu – Faleminderit!

Së pari, dua të shpreh konsideratat më të larta për drejtuesit e rinj të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, meqenëse kam pasur fatin të punoj më të dy drejtuesit. Drejtoria e

Përgjithshme e Burgjeve, nën drejtimin tuaj, në kuptimin e vlerave, do të jetë në maksimum. Me këtë rast ju uroj punë të mbarë dhe një bashkëpunim të frytshëm. Unë mendoj se duhet të jemi më seriozë dhe më mbështetës në lidhje me problematikën që ju ngrini.

Ka një problem dhe dua të bëj një koment për konceptimin apo psikozën që ka politika jonë majtas dhe djathtas në raport me disa institucione ligjzbatuese duke i lënë mbas dore, si sistemi penitenciar i burgjeve. Ky institucion për nga rëndësia nuk vjen pas policisë, prokurorisë apo gjykatës, por është në ciklin e organeve ligjzbatuese. Pra, nëse mendojmë për një person të izoluar nga shoqëria për shkak të rrezikshmërisë shoqërore ta risocializojmë dhe ta kthejmë në normalitet, është pikërisht sistemi penitenciar që e bën këtë të mundur. Pra e mban të izoluar, por edhe punon çdo ditë që personi të mos rikthehet më në aktivitet kriminal. Ky institucion ka një rëndësi shumë të madhe, por, në fakt, nuk njihet. Por çfarë duhet pasur parasysh? Nuk e di nëse është zgjidhur çështja e uniformës, që është ana vizive e Policisë së Burgjeve, por duhet të fillohet që nga uniforma. Me thënë të drejtën, kur i shikoj rrugëve, duken shumë keq. Pra është një histori që duhet të mbarojë dhe Policia e Burgjeve anën vizive duhet ta ketë po aq dinjitoze sa Policia e Shtetit dhe të gjitha strukturat e tjera që kanë uniformë.

Nga ana e trajtimit financiar, ka ardhur koha që të mos e shikojmë njërin me syrin e nënës dhe tjetrin me syrin e njerëzës. Nëse në Policinë e Shtetit ka një trajtim, atë duhet ta ketë edhe Policia e Burgjeve. Pra, duhet të unifikohet paga për shkak edhe të unifikimit të gradave. Nëse kemi unifikuar gradat me Policinë e Shtetit, atëherë automatikisht duhet bërë edhe unifikimi i pagave, gjë që qeveria duhet ta bëjë. Kjo kuptohet që bëhet me shumë sforco, por është shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e shërbimit dhe kjo kategori të dënuarish të ketë personel me uniform, të kualifikuar, të paguar dhe të trajtuar dhe jo njerëz që vijnë për të marrë një rrogë dhe nuk dinë se çfarë bëjnë.

E treta, dua t'ju sugjeroj, zoti drejtor, që të ndërhyri në ligjin për Policinë e Burgjeve dhe të ndryshoni me ligj disa ngjyra që kanë të bëjnë me ato që thashë, pra me trajtimin dhe unifikimin e pagave, sepse ndryshe nuk do të bëhen asnjëherë. Pra, duhet të ndërhyri në ligj dhe të rregulloni të gjithë sistemin e burgjeve që të shkojmë aty ku duhet.

Duke pasur parasysh kushtet e punës, ju e ngritët si problem që në disa vende kushtet nuk janë të mira, sidomos në sistemin e paraburgimit, por edhe në burgje ka probleme serioze, prandaj duhet të ndërhyjmë me investime. Nuk e di se sa e ezauron niveli i investimeve këtë problem, por nga ana tjetër, nëse ne bëjmë një investim dhe nuk e shoqërojmë me punonjës, atëherë kjo nuk ka

kuptim. Për shembull, marrim rastin e burgut 313, ku është bërë një investim, por themi që nuk ka personel. Kjo do të thotë që lekët kanë shkuar kot. Atëherë duhet të gjendet mënyra që ta plotësojmë me personel dhe me mjekë, sepse edhe shërbimi mjekësor aty lë për të dëshiruar.

Kur kemi qenë në Policinë e Shtetit, kemi pasur probleme me personat që ishin në paraburgim, por edhe kur duhet t'i çonim në spitale për mjekim, kishte shumë shpenzime, sepse merrej edhe Policia e Shtetit për mbështetje. Pra i bëhej një dëm i madh shtetit, sepse është një kosto shtesë që vjen për shkak të kësaj.

Unë mendoj që ne si komision duhet të bëjmë disa rregullime, të cilat duhet t'i dakordësojmë këtu pastaj t'i negociojmë nëpërmjet kryetares apo komisionit, që të paktën të ezaurohen disa pika të domosdoshme me këtë buxhet. Ju duhet të formatoni disa nevoja pa të cilat do të cedonte niveli i shërbimit.

Të gjithë diskutimin tim e solla si koment për të mos bërë pyetje, sepse ju i sqaruat të gjitha me këtë material dhe pyetjet janë të tepërta për mua. Unë mendoj se duhet të gjejmë një ekuilibër si komision për t'ju ndihmuar sa të jetë e mundur dhe sistemi penitenciar të ketë trajtimin e duhur.

Faleminderit për pjesëmarrjen dhe për shpjegimet!

Edhe një herë shpreh bindjen se sistemi i burgjeve ka marrë vlera të padiskutueshme në drejtim dhe ne duhet ta shoqërojmë me mbështetje financiare logjistike dhe të llojeve të tjera.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Unë dua ta bashkoj ndërhyrjen time me fjalën e zotit Ndreu, duke parë buxhetin e burgjeve të thjeshtëzuar në tri komponentë, ku një komponent shkon për trajtimin e punonjësve të burgjeve, pra për të gjithë strukturën e burgjeve dhe jo vetëm policisë.

Komponenti tjetër ka të bëjë me rritjen e sigurisë në burgje, që është shumë i rëndësishëm në interesin publik dhe, natyrisht, është detyrimi parësor i të gjithë strukturës drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Komponenti i tretë lidhet me një trajtim sa më të përshtatshëm, që ruan nivelin standard të të drejtave dhe lirive të njeriut, për të gjithë personat që janë të paraburgosur ose të dënuar. Duke parë buxhetin në këto tri drejtime, do t'ju kërkoja që kërkesat tuaja t'i përqendroni sipas këtyre tre drejtimeve, në secilën prej këtyre komponentëve, se cilin fond do ta kishit më shumë të nevojshëm, në mënyrë që të jemi sa më konkrete te raporti që duam t'i drejtojmë Komisionit të Ekonomisë, sepse ai është komisioni që vendos për të gjitha kërkesat që vijnë nga komisionet tona

parlamentare. Ne duhet të bëjmë një kërkesë të mirargumentuar në mënyrë që ta sigurojmë mbështetjen financiare.

Fjala është për zotin Braho.

Spartak Braho – Faleminderit, zonja kryetare!

Nuk dua të zgjatem në argumente, sepse i thanë Xhemali, Pjerini dhe ju. Ne biem dakord parimisht për reformat që po zhvillon kjo qeveri në të gjithë sistemin e organeve të drejtësisë, si në atë të policisë, por edhe të policisë së burgjeve, që është një sektor shumë i rëndësishëm dhe i veçantë.

Kush ka punuar në këto organe, e kupton se çfarë do të thotë burg apo regjim burgimi. Këto vite burgjet tona u kthyen në stalla apo vathë për ruajtjen e deleve dhe jo të njerëzve. Nuk e di përse përfunduan kështu, por është një paraqitje dhe një kujdes i pamjaftueshëm. Ne mbajmë njerëz atje dhe qëllimi kryesor i vuajtjes së dënimit, ashtu siç thuhet, është riedukimi dhe futja e tyre në jetën normale qytetare. Prandaj duhet një kujdes i veçantë, që edhe ata që u shërbejnë këtyre njerëzve të trajtohen si njerëz. Unë jam dakord që shtesa dhe përafrimi duhet të jetë me atë trajtim që merr Policia e Shtetit.

Më kujtohet vite më parë që polici i burgut merrte edhe vështirësi. Ju nuk e dini, por kush është i vjetër këtu e di që polici i burgut merrte vështirësi, pra shtesë mbi pagën për shkak të natyrës së detyrës që kryente.

Zonja kryetare, ne si komision propozojmë dhe mbështesim, por ne duhet të ndikojmë fuqishëm. Komisioni i Ligjeve për këtë problem, por edhe për shumë probleme të tjera, që u diskutuan, do të ketë një ndikim nëpërmjet një kontakti direkt në Komisionin e Ekonomisë, madje u ngarkua kryetari i Komisionit të Ekonomisë së bashku me një shok tjetër që të jenë të pranishëm kur ky komision të vendos për këto rregullime dhe propozime, pasi ky është autoriteti i komisionit. Ashtu siç kemi bërë vjet, por edhe vite më parë ne duhet me patjetër ta realizojmë dhe duhet t'i imponohemi Komisionit të Ekonomisë që këto shtesa, që këta kanë paraqitur, në masën më të madhe të gjejnë përkrahje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Braho!

Fjalën e ka zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja Kryetare!

Edhe unë dua t'i uroj suksese zotit Çipa, me të cilin kam pasur një bashkëpunim shumë të mirë dhe jam e bindur që si drejtor i burgjeve do ta bëj diferencën.

Ky prezantim kaq i detajuar tregon seriozitetin e përkushtimin që ka dhe neve na e bën më të lehtë punën për ta mbështetur Drejtorinë e Burgjeve me nevojat që ata kanë. Këtu u tha nga të gjithë kolegët, prandaj edhe unë i bashkohem mbështetjes për nevojat që kanë.

Dy gjërave dua që t'i kushtoj më tepër vëmendje. Në relacionin që kemi flitet për VKM-në që parashikon numrin total të punonjësve në Drejtorinë e Burgjeve, ku ne si komision mundemi t'u sigurojmë mbështetje.

E dyta, ka të bëjë me mbështetjen për pagat e mjekëve dhe që mendoj që ky institucion ka nevojë për mbështetje më të specializuar, për sa i përket trajtimit mjekësor, sepse nëse nuk kemi mjekët aty, nuk mund të flasim për shërbime, materiale mjekësore e të tjera, ashtu siç thuhet në buxhet. Prandaj jam në mbështetje të kësaj kategorie pa lënë mënjanë unifikimin e pagave të Policisë së Burgjeve me Policinë e Shtetit, që është shumë e domosdoshme, aq më tepër që është edhe një premtim i ministres së Drejtësisë dhe besoj se do të gjejë zgjidhje.

Nuk e di nëse te pjesa e mjekëve ka për të thënë diçka më specifike dhe si kërkohet kjo mbështetje.

Faleminderit!.

Ermonela Felaj – Po, zoti Çipa.

Stefan Çipa – Në prill të vitit 2017 është miratuar VKM-ja me numrin total të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, pra si të punonjësve civile, por edhe atyre me uniformë. Që nga viti 2017 deri më sot kanë ndodhur disa ndryshime. Ka hyrë në funksion të plotë EVP-ja e rrethit në Shkodër, që është burg me popullim të madh dhe pritet të futet në funksionim EVP-ja e re te “Jordan Misja”, që është brenda parametrave bashkohorë. Këto ndryshime që kanë ndodhur ose pritet të ndodhin, si salla e re operative, që do të bëjmë, kërkojnë staf dhe këto shtesa që kërkojnë janë shumë të domosdoshme. Pra, nuk kanë kuptim investimet nëse nuk i vendosim dot në shfrytëzim, sepse nuk mund të çojmë ne të paraburgosur pa pasur fuqi punëtore.

Edhe për problemin e sallës operative, e cila është shumë e rëndësishme për vetë funksionin që ka, po e bëjmë me një numër minimal, pra 16 punonjës policie dhe duhet t'i shtojmë edhe 8 punonjës, sepse është e detyrueshme.

Për pagat e mjekëve. Ne kemi një strukturë të cunguar për numrin e mjekëve te spitali i burgjeve, por edhe pranë çdo EVP-je. Pra është e domosdoshme që të shtojmë 7 mjekë dhe 12

infirmierë. Paga e mjekëve është e kategorisë së fundit në këto institucione, edhe një mjek që punon në QSUT nuk e ka aq, pra e kanë më të vogël dhe mendoj se punojnë në kushte të vështira, me të dënuar. Për këtë arsye ata nuk pranojnë të punojmë dhe nuk vijnë. Është shqetësimi më i madh kur na largohen përditë. Ne shtojmë dy godina për trajtimin e të sëmurëve me mjekim të detyruar dhe nuk kemi mjekë. Spitalet e burgjeve, për pjesën administrative duhet të administrohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe ne të kishim vetëm ruajtjen, por sidoqoftë e ka Ministria e Drejtësisë, e cila duhet t'i trajtojë këto mjekë, sepse po na largohen përditë.

EVP-në e Shkodrës kemi një muaj që e kemi hapur me gjysmë kapaciteti dhe ishte një event i madh që doli një pensionist, i cili pranoi të punonte si mjek. Kjo është situata reale. Pra, kërkojmë që mjekët të kenë një pagë të mirë që të kemi mundësi t'i thërrasim, sepse nuk pranojnë që të shërbejnë në sistemin e burgjeve. Pra paga e mjekëve dhe fuqia punëtore është domosdoshmëri.

Kemi kërkuar 25 mirëmbajtës që është shumë e rëndësishme, le t'i lëmë që vitin tjetër të mos ketë, por këto gjëra i kërkojmë ne. Burgjet dhe sallat e reja operative, nuk i hapim dot po nuk patëm njerëz.

Sa i përket unifikimit, ku u ndal edhe zoti Qefalia në mbështetje të Policisë së Burgjeve, është realisht ashtu.

Unë dhe zonja Gjebrea kemi folur për rëndësinë e burgjeve. Policia e Burgjeve punon dhe është pranë të burgosurve, por punonjësi i Policisë së Burgjeve has vështirësi që tek uniforma që duhet të ketë, te paga që lë shumë për të dëshiruar, madje nuk merr as vështirësi. Ne kërkojmë që paga t'i shkojë sa e Policisë së Shtetit. Nga shtesa prej 177 milionë që do të jepet, rritet vetëm 7% paga bazë dhe zero për qind paga për gradë dhe funksion. Për mendimin tim, duhet të rritet paga në total.

Ermonela Felaj- Zoti Çipa, sipas materialit që na keni dhënë, 16 punonjës policie për sallën operative ju janë miratuar paraprakisht nga financat.

Stefan Çipa – Jo nuk janë miratuar nga Ministria e Financave, janë kaluar në total nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Financave dhe **71** nuk është i mbështetur në fond page.

Ermonela Felaj - A mund të na sqaroni?

Mirjana Zisi- Atëherë, për Ministrinë e Drejtësisë janë miratuar 71 funksione, por janë për institucionet, si: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Qendra për të Miturit dhe Instituti i të Miturve. Kjo është kërkesë e Kodit Penal për të Miturit dhe që me datën 1 janar të vitit 2019 këto

tri institucione duhet të fillojnë nga puna me një strukturë minimaliste. Kështu që ato 70 punonjës janë për këto 3 institucione. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve nuk kemi asnjë numër të rritur. Burgu i Tiranës “Jordan Misja” do të ketë një kapacitet shtesë 260 të paraburgosur. Si do të ruhen këta? Në sallën operative do të punojnë me 3 turne, 16 punonjës duhen patjetër, 34 punonjës për njësinë speciale, duhen mjekë dhe infermierë, siç e thamë. Sapo është miratuar një VKM për 95 milionë lekë për dy projekte për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për sallën operative.

Ermonela Felaj – Kur mbaron investimi?

Po shtesa prej 120 punonjësish për burgun 313 pse nevojiten? Ai burg po ristrukturohet, nuk i ka punonjësit ai?

Stefan Çipa– Po ristrukturohet.

Ermonela Felaj– Po prisni të rritet numri i të burgosurve apo do të merrni të burgosur nga një burg tjetër? Nuk e kuptoj pse duhet një shtesë kaq e madhe? Për mbipopullimin kemi ndërhyrë disa herë me amnisti dhe unë nuk dua të abuzoj shumë me këtë pjesë. Ne mund të jemi i vetmi vend që kemi bërë çdo vit amnisti. Shqipëria kjo është dhe këto nevoja ka, por ne duhet të bëjmë më të domosdoshmet. Të fokusohemi dhe të kuptojmë pse duhen 120 punonjës dhe pse po bëhet një godinë e re.

Stefan Çipa - Burgu 313 “Jordan Misja” është institucion paraburgimi, ngaqë është pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda ka një mbipopullim të paraburgimi. Te burgjet nuk kemi mbipopullim. Në paraburgimet kemi mbipopullim, ato shërbejnë edhe për të burgosurit transit që vijnë për gjyqe në Tiranë, ose për mbrojtjen e dëshmitarëve të drejtësisë e të tjera. Pra, është shtesë kjo fuqi punëtore që kërkojmë, nuk është çështja e ndërtimit të një burgu të ri, por e shtesës së kapaciteteve të reja për këto që janë.

Antoneta Dhima – Faleminderit!

Prezantimi i bërë nga drejtori i përfshin të gjitha kërkesat që institucioni juaj ka.

Krahasuar me realizimin e pritshëm të vitit 2018, fondet e planifikuara, të cilat ju janë dhënë si institucion nga Ministria e Drejtësisë janë me rritje? A e plotësojnë ato misionin tuaj?

Sipas një informacioni që unë kam në IEVP të ndryshme ka probleme me armatimin personal të personelit të policisë si dhe me mjetet autoambulanca, autobusë. A keni planifikuar ju në buxhetin e vitit 2019 që ky problem të zgjidhet deri diku. Dihet pak a shumë dihet që burimet janë të kufizuara dhe nevojat janë të pakufizuara. Sipas informacionit që unë kam ka probleme edhe me medikamentet. A i keni planifikuar ju në buxhetin e vitit 2019?

Stefan Çipa - Në lidhje me investimet e planifikuara për vitin 2018, po ju them se realizimi deri tani është në masën 92%, dhe mendojmë që deri në fund të vitit ta realizojmë pa djegur asnjë fond nga ato. Po ta marrësh si trend investimesh është e mirëkuptueshme, por në këtë vit ka pasur më pak investime, ne nuk kemi planifikuar burgje të reja, sepse kanë qenë financime të BE-së dhe qeverisë shqiptare për burgun e Shkodrës, për shembull, dhe 325 milionë për burgun 313.

Në lidhje me shqetësimin për armatimin e punonjësve të burgjeve, ne kemi planifikuar një ripërtëritje të armatimit, sepse është shumë i vjetër dhe kemi planifikuar një fond si për uniformat, ashtu edhe për armatimet. Por, në fakt, duhen edhe investime për ruajtjen e armatimit, pra mjete sigurie.

Për sa u përket ambulancave dhe mjeteve të tjera të transportit, në fakt, ato lënë për të dëshiruar. Është planifikuar këtë vit që nga të ardhurat që kemi të pajisen 3 spitale: spitali qendror që kemi në Tiranë, do të bëjmë një spital të ri në Lezhë dhe pastaj edhe IEVP e Ali Demit dhe spitalin e Durrësit që shërben për mjekim të detyruar.

Sa u përket medikamenteve, kemi caktuar një fond për medikamentet më të rëndësishme që ne kemi. Por, duke rikonstruktuar spitalet dhe duke pasur mjekët në ambulanca na kursejnë një numër të madh forcash sigurie që na duhen për të sëmurët e burgosur.

Luan Harusha- Faleminderit!

Së pari, unë them se kërkesat tuaja do të kenë mbështetjen e Komisionit të Sigurisë.

Mesa jam në dijeni unë, sa i përket burgut të Reçit në qarkun e Shkodrës, Ministria e Drejtësisë ka përcaktuar një numër punonjësish të administratës së këtij burgu. Kemi pasur kontakte me drejtorinë e burgut disa herë dhe na janë paraqitur disa ankesa në lidhje me plotësimin e stafit me mjekë, infermierë, edukatorë, me furnizimin me ilaçe, pasjen e një autoburgu. Këto janë disa kërkesa të domosdoshme, sepse është burg i ri.

Ka pasur disa punonjës që kanë aplikuar vitin e kaluar pranë drejtorisë suaj, kanë marrë uniformat, por nuk kanë marrë asnjë informacion tjetër.

Stefan Çipa – Në lidhje me burgun e Reçit në Shkodër nuk kemi kërkuar punonjës, sepse ishte planifikuar për vitin që vjen,. Thuhet se nuk kemi realizuar fondin e pagave, por në funksion burgu i Shkodrës ka funksionuar në 6-mujorin e dytë. Pas përrurimit, u mor një staf relativisht i ri, u trajnuar, kemi që nga fillimi i muajit tetor që kemi filluar funksionimin normal të IEVP-së së Shkodrës. Si burg i ri ai ka 100% të gjitha kushtet, por e monitorojmë me staf nga Drejtoria e

Përgjithshme e Burgjeve sa të krijohen, nuk kemi filluar të popullojmë paraburgimin në Shkodër. Tani të gjithë të dënuarit që janë nga Shkodra dhe rrethinat përreth po i afrojmë që të jenë sa më afër familjarëve dhe jemi në një fillim të mbarë të punës aty, me kushte bashkëkohore.

Në lidhje me stafin, unë e thashë që në fillim se në sistemin e burgjeve është rekrutuar staf mbi bazën e qokave të partive. Por me urdhër të Kryeministrit është bërë një marrëveshje bashkëpunimi midis Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë që i gjithë stafi që rekrutohet në Policinë e Burgjeve duhet të konkurrojnë në Akademinë e Policisë. Ne kemi filluar trajnimet, madje ka edhe nga Shkodra, rreth 30 vetë, që shkojnë në trajnim 1 muor tek Akademia e Sigurisë. Është parë vetëm kriteri profesional në rekrutimin e tyre. Kuptohet me ambulancën kemi pak probleme, sepse distanca nga Shkodra është e madhe, kemi vështirësi në mjekë dhe infermierë derisa ta kompletojmë. Jemi duke u marrë me shqetësimet që ngritët ju.

Luan Harusha - Doja të di buxheti për stafin është i miratuar apo pritët të miratohet?

Stefan Çipa- Për burgun e Shkodrës numri i stafit është i miratuar.

Luan Harusha- Punonjësit kanë marrë uniformat dhe i mbajnë në shtëpi.

Stefan Çipa - Ne gradualisht jemi duke u marrë me trajnimet. Disa nga ata që kanë filluar largohen, sepse nuk e përballojnë, por do t'ju vijë radha të gjithëve.

Luan Harusha- Janë trajnuar, kanë marrë edhe uniformat dhe tani kërkojnë një përgjigje.

Ermonela Felaj – Besoj se është e qartë, Luan, janë duke u trajnuar dhe do të rekrutohen. Drejtori po thotë që kanë konkurruar, nuk janë trajnuar.

Trajnimi dhe testimi janë tjetër.

Vullnet Sinaj- Si rrallë ndonjëherë korrespondojnë të gjitha problemet që ngriti drejtori me ato që unë kam marrë nga një vizitë që kam bërë në paraburgimin e Vlorës. Të gjitha problemet që ngriti zoti Çipa këtu janë të njëjta duke filluar që nga pajisja me uniforma, të cilat i kanë blerë me lekët e tyre, apo mungesës së një furgoni për të transportuar të burgosurit drejt gjykatës, sepse mjetet janë të amortizuara, janë me probleme. Njëkohësisht mund të them se paraburgimi i Vlorës nuk ka fare ambulancë. Po kështu vazhdojnë problematikat për izolimin e tarracës. Ju folët për problemet tuaja, unë po i shtoj.

A ka përfaqësues të Ministrisë së Financave?

Ermonela Felaj– Po.

Vullnet Sinaj- Mbani shënim këto që do të them, ju lutem, sepse, në fakt, nuk janë për zotin Çipa, janë më shumë për ministrinë tuaj.

Mua më duket se nga të gjitha institucionet që kanë ardhur në komisionin tonë për të shprehur kërkesat, Drejtoria e Burgjeve ka më shumë probleme dhe duhet ndihmuar si nga ne si komision, ashtu edhe nga Ministria e Ekonomisë, sepse mund t'i anashkalojmë kërkesat e tyre se janë burgje, por në të vërtetë ato janë institucione të vuajtjes së dënimit dhe të rehabilitimit dhe janë shumë të rëndësishme për sigurinë e vendit. Kërkesat janë për gjëra të domosdoshme, nuk mund të diskutohet sot për mungesë të një mjeti lëvizës për të paraburgosur në gjykatë ose mjet lëvizës për të sëmuri, që është në paraburgim për të vajtur në spital.

Unë kam edhe një shqetësim tjetër të përgjithshëm për ata që kanë kryer vepra penale, por që janë të papërgjegjshëm. Sipas nenit 46 i Kodit Penal ata nuk marrin dënim, por duhet të marrin mjekim të detyrueshëm dhe ta bëjnë në institucione të specializuara mjekësore, sepse sot ndodhen në spitalet e burgjeve, por nuk janë të dënuar. Pra, është një paradoks dhe plagë për shoqërinë. Unë kam hasur edhe në terren, në zonën që mbuloj, njerëz që e kanë vuajtur këtë gjë. Nuk e di se çfarë ka bërë Ministria e Drejtësisë me këto institute mjekësore të specializuara për kurimin e këtyre personave që janë të papërgjegjshëm dhe kanë kryer vepra penale. Do të doja një përgjigje nga ju, besoj se Ministria e Drejtësisë e ka këtë detyrë.

Ermonela Felaj – Besoj se zoti Çipa do ta risqaroj përsëri këtë çështje, pasi ai e përmendi edhe në pjesën hyrëse që diçka do të bëhet në Lezhë, megjithatë për më shumë fjalën e ka zoti Çipa.

Stefan Çipa – Gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit i kemi me mjekime të detyruara. Aktualisht, përveç spitalit të burgjeve ata trajtohen në IEVP-në e Krujës, e cila ka probleme, sepse është një IEVP e vjetër. Siç edhe jua përmenda ka filluar edhe rikonstruksioni, ku në hyrje të qytetit të Shkodrës janë liruar dy godina, godina 4 dhe 5 e burgut të Lezhës, të cilat do të përshtaten vetëm për këtë kategori të dënuarish, pra për trajtimin e atyre që janë mjekim të detyruar.

Si kapacitet në total, pra me këto shtesa që ne do të bëjmë me dy godinat, do të kompletohet rreth 70% e tyre, duke liruar Krujën, ndërsa pjesa tjetër do të trajtohet në IEVP-të e tjera. Është e vërtetë që lë për dëshiruar, por me rikonstruksionin, i cili po ecën me ritme të shpejta mendojmë që brenda këtij viti ose e shumta janari i vitit që vjen, sepse është një investim në vazhdim, ne do të fillojmë edhe në bazë të kushteve normale, trajtimin e kësaj kategorie të dënuarish që ne kemi për IEVP-të në Lezhë.

Ermonela Felaj – Zoti Çipa, meqenëse jemi te kjo pikë, burgu famëkeq i Zaharisë, sepse është konsideruar si i tillë, a do të mbyllet përfundimisht me përshtatjen e këtyre dy godinave në Lezhë?

Stefan Çipa – Po, do të mbyllet, pasi atje do të kalojë e gjithë...

Ermonela Felaj - Pra, ju mendeni që burgu i Zaharisë këtë vit do të mbyllet?

Stefan Çipa – Po.

Ermonela Felaj – Mendoj se burgu i Zaharisë është një faqe negative për historinë e burgjeve. Kolegët tanë deputetë të nënkomisionit për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut kanë bërë një vizitë në këtë burg. Media e ka marrë shumë shpejt këtë çështje dhe e ka trajtuar këtë problem. Ata që kanë punuar në strukturat e prokurorisë dhe të gjykatës e dinë shumë mirë që është një problem i rëndë jo thjesht dhe vetëm për ata persona, por edhe gjithë njerëzit që i rrethojnë. Për mua kjo është një ndërhyrje, siç e thotë edhe shprehja “Më mirë vonë se kurrë”.

Faleminderit, zoti Sinaj!

Zoti Duzha, kishte një pyetje.

Luan Duzha – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti Drejtor, për gjithë ekspozenë që na bëtë për projektbuxhetin, pasi ishit shumë konciz në kërkesat tuaja, të cilat janë mjaft të domosdoshme!

Unë kisha një pyetje. A keni ndonjë numër të përafërt sesa është mbipopullimi në paraburgime, pasi në dijeninë time ka të dënuar në paraburgim, të cilët flenë në dysheme me dyshek? A zgjidhet kjo situatë nga këto dy IEVP-të që do të bëhen të reja?

Stefan Çipa – Me shtimin e kapacitetit të plotë të IEVP-së së Reçit, e kemi shtuar kapacitetin akomodues edhe para se të vihej në funksion ky burg. Pra, kemi pasur mbipopullim kryesisht në paraburgimet në Tiranë, por edhe në vende të tjera si në Elbasan, Vlorë, pasi këto janë institucione vetëm për paraburgimet. Me hyrjen në funksionim të 313-ës të “Jordan Misjes” dhe me 180-të paraburgimet që kemi për JOP-në e Shkodrës, kjo gjë do të normalizohet dhe nuk do të kemi më mbipopullim.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Braho.

Spartak Braho – Po shfrytëzoj rastin për të ngritur një problem tjetër. Nuk e di a është në projektet dhe në planet e Ministrisë së Drejtësisë rinovimi i ligjit për burgjet. Ky është një ligj i vjetër, pasi unë jam deputet që nga viti 1996, janë bërë ndryshime herë pas here, por ligji aktual

nuk është një ligj që e nderon sistemin që Ministria e Drejtësisë ndjek dhe ju e drejtoni. A keni jurist në grup?

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Çipa, patjetër duhet të filloni të hartoni dhe të ngrini një grup pune, për të planifikuar rregullimin e ligjit për burgjet. Ky ligj është shumë anakronik, ai ka disa kompetenca dhe funksione që i kryen institucioni juaj, por ka mangësi të mëdha që lidhen me kriteret e emërimeve, rekrutimeve e shumë të tjera. Unë nuk e kuptoj se çfarë kërkon SHÇKB-ja aty për shumë gjëra që u ka kaluar koha, të cilat do të shkurtohen. Nuk mundet SHKÇB-ja të dalë mbi kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe tuajat.

(Diskutime pa mikrofon)

Mua më keni në dispozicion si deputet, si legjislator i vjetër, për ta rregulluar ligjin.

Ermonela Felaj – Më lejoni edhe mua, zoti Braho, t'i bashkohem idesë suaj, jo për shkak dhe vetëm të faktit që ligji, i cili trajton Policinë e Burgjeve është i vjetër dhe ne duhet t'u përshtatemi koncepteve të reja në kohë, por edhe kur bëjmë një diskutim të thjeshtë, siç është ai rritjes së pagave normal që mendja të shkon te ligji. Pse shkon te ligji? Ne sot po përpiqemi që gjithë strukturën e Policisë së Shtetit dhe punonjësit që janë pjesë e saj t'i kemi nga Akademia e Sigurisë, pra të jenë me shkollë të lartë, kurse te burgjet këtë standard ne nuk e kemi te burgjet. Unifikimi i pagave në një moment që këta nuk kanë të njëjtin shkollim nga pikëpamja se si e sheh ligji një jurist kjo nuk mund të rrijë.

Unë besoj se kjo gjë është edhe në nevojën tuaj dhe në detyrimin që të gjithë kemi që të ndërhyjmë te ligji në mënyrë që të përmirësojmë kapacitetet njerëzore, të marrim kapacitet e duhura brenda sistemit të burgjeve dhe më pas, ata vërtet ta meritojnë edhe trajtimin me pagë. Unë e kuptoj që një njeri me shkollë të mesme, sepse me shkollë të mesme janë te burgjet, prandaj jo më kot është përdorur politikisht i gjithë sistemi i burgjeve për punësime, të vijnë dhe të trajtohen njësoj si dikush që ka arsimin e lartë. Pra, nga pikëpamja e përkushtimit ndaj shkollës kjo gjë nuk do të ishte e drejtë.

Natyrisht, nuk mund t'ju them që punonjësit e burgjeve nuk kanë vështirësi, sepse ata kanë vështirë, por a duhet që edhe ne t'i rrisim kërkesat e llogarisë ndaj tyre? Po, që burgju në fund të fundit të mos shihet thjesht dhe vetëm si vend pune për të marrë një pagë në fund të muajit, por të shihet nga ata që rekrutohen në sistemin e burgjeve edhe si një përgjegjësi ndaj shoqërisë.

Patjetër, ligji i ri duhet bërë menjëherë!

Stefan Çipa – Realisht ka ardhur koha që i gjithë ligji për organizimin e Policisë së Burgjeve të përmirësohet. Në dijeninë time është bërë e mundur ngritja e një grupi pune pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Ministrisë së Drejtësisë, i cili është duke punuar dhe shumë shpejt kjo gjë do të bëhet e mundur. Në ligjin që kemi aktualisht, po të shohësh nenin 5 të tij, thuhet: “Punonjësi i Policisë së Burgjeve duhet të ketë statusin si punonjësi i Policisë së Shtetit”.

Realisht, për efekt të këtyre disbalancave, kjo gjë është parë, sepse te Policia e Burgjeve nuk vjen njeri, pasi me shkollë të mesme janë konkurrentët e Akademisë së Sigurisë, po ashtu shkollë të mesme kemi bërë edhe ne që jemi te Policia e Burgjeve, pra pak a shumë është i njëjti trajtim. Ata që vijnë me shkollë të lartë janë punonjës të rolit të mesëm si komisar, kryekomisar dhe vazhdojnë njësoj si te Policia e Shtetit. Madje, ne kemi edhe një qendër trajnimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe në bazë të marrëveshjes tani trajnohemi tek Akademia e Sigurisë. Pra, kanë të njëjtën nivel dhe ngritje arsimore, por nuk vijnë te burgjet, sepse nuk dhe nuk marrin vështirësi. Pavarësisht se punonjësi i policisë ka të njëjtin arsim, vështirësia te sistemi i burgjeve është shumë e madhe.

Unë i rikthehem asaj që thashë edhe pak më parë, pasi kam folur shumë edhe për Policinë e Shtetit dhe i di të gjitha vështirësitë, por, duke e njohur shumë mirë Policinë e Burgjeve, jua them me bindje se vështirësia është minimumi që ata duhet të marrin, aq më tepër kur ne kërkojmë unifikim dhe barazim, pasi ka një disproporcion që nuk e ka asnjë vend edhe pse janë të njëjtat kriteret.

Ermonela Felaj – Faleminderit për sqarimin!

Mendoj që debatin ta mbyllim këtu, duke fiksuar dy sqarime të vogla.

E para, sa shkon shtesa e buxhetit për 216 punonjësit shtesë që ju kërkon, pasi edhe nga shpjegimet që na dha zoti Çipa, u konsiderua si e domosdoshme?

Pra, 16 punonjës policie në sallën operative, 34 punonjës për njësinë speciale, 7 mjekë për të gjitha IEVP-të dhe DPB-të, 14 infermierë, 120 punonjës për 313-tën dhe 25 mirëmbajtës për sistemin e burgjeve. Doja të dija se sa shkon shtesa për këta?

E dyta, ndoshta nuk është thjesht shtimi i numrit të mjekëve kryesori, sepse ne edhe për sistemin e përgjithshëm shëndetësor po japim bonuse që t'i nxisim mjekët të japin shërbim në të gjithë Shqipërinë, në spitalet dhe qendrat shëndetësore publike.

Po rri te mjekët që janë aktualisht në sistemin e burgjeve. Sa është numri i tyre? Të përpiqemi të barazojmë trajtimin e tyre financiar me atë të mjekëve që janë nëpër spitalet e

zakonshme shtetërore. Të paktën ta sigurojmë këtë, sepse, ja e shtuan pagën për mjekët dhe kapacitetet, por sa të sigurt jemi që ata do të shkojnë atje? Pra, pak a shumë kemi të njëjtin problem, i cili është përgjithësisht për shëndetësinë dhe jo thjesht për burgjet. A mund t'i fiksojmë këto çështje që edhe ne të jemi konkretë te kërkesa jonë drejtuar Komisionit të Ekonomisë?

Marjana Zisi – Fondi i pagave për 216 punonjës është 36 milionë lekë. Shtesa e pagave për barazimin e gradës dhe shtesës për vjetërsi në punë për 3559 staf policor është 643 milionë lekë.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, jam duke folur me të reja, sepse bëhet fjalë për 3550 punonjës policie për 1 vit.

(Diskutime pa mikrofon)

Sa i takon klasifikimit të pagave të mjekëve, më lejoni, t'ju them vetëm një shembull. Një farmacist paguhet njësoj si një magazinier dhe kjo është për të ardhur keq, e jo më pas mjekët me 4 A, ose me 4 B, njësoj si specialisti i arkivit.

Ermonela Felaj – Sa i takon sistemit të burgjeve, nëse e barazojmë pagën e mjekëve që punojnë atje me atë të mjekëve që punojnë në sistemin e zakonshëm, sa do të shkonte shtesa?

Marjana Zisi – Do të shkonte 38,4 milionë ose më saktë 38 milionë lekë.

Ermonela Felaj – Jam duke folur për ata që janë aktualisht jo për ata që vijnë, pra për t'ju ndryshuar pagën atyre që janë aktualisht.

Sa shkon?

Stefan Çipa – Shkon 38,4 milionë, gjithmonë me të reja.

Marjana Zisi – Gjithmonë bëhet fjalë për pagën e 1 viti.

Ermonela Felaj – Sa mjekë kemi aktualisht në sistemin e burgjeve në gjithë Shqipërinë? Pra, këta mjekë janë të përqendruar vetëm në sistemin e burgjeve dhe nuk punojnë...

(Diskutime pa mikrofon)

Marjana Zisi – Ka mangësi edhe për dentistë, pasi ata nuk vijnë, sepse pagat janë shumë të ulëta.

Stefan Çipa – Në total janë 112 mjekë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se jemi të qartë për kërkesat dhe për numrin. Ne do të përpiqemi maksimalisht, duke u bazuar në argumentet që na dhatë ju, por edhe kolegët, të cilët mbështetën fjalën tuaj, të

arrijmë me aq sa është e mundur të plotësojmë maksimalisht nevojat, ndoshta për hir të së vërtetës nuk janë të vogla...

Marjana Zisi – Kërkesat janë shumë të mëdha, por gjithsesi mendoj se duhet të merren parasysh gradualisht...

Ermonela Felaj – Ne duhet të jemi të vetëdijshëm që t'i plotësojmë gradualisht. Përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë nuk e pyetëm, por do të doja të dija se sa mund të gjenerojmë nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, nga rialokimi i zërave të ndryshëm që ka kjo ministri, sepse në fund të ditës përgjegjësia e funksionimit i takon këtij institucioni qendror. Të gjitha institucionet qendrore përveç buxhetit të shtetit kanë edhe ndihmën e huave, prandaj mendoj se me një menaxhim sa më të mirë mundet t'u dilet përballë këtyre nevojave. Pra, ne mos të përqendrohemi tek të gjitha burgjet, por fjala bie te burgjet e sigurisë së lartë, sepse aty kemi më shumë interes për të shtuar trajtimin, sigurinë e të tjera, e më pas të zbresim te burgjet e sigurisë së ulët dhe burgjet e sistemit të zakonshëm.

Antoneta Dhima – Sa i takon pjesës së mirëmbajtjes, ajo është mjaft e rëndësishme, sepse disa burgje janë rikonstruuar dhe janë në gjendje të mirë, por edhe mirëmbajtja e tyre ka rëndësinë e vet. Ajo çka do të rekomandoja është që të angazhohet pjesa e të burgosurve, të cilët kanë zanate. Pra, të gjitha drejtoritë e burgjeve mund ta blejnë gëlqeren, bojën dhe të gjitha materialet dhe të angazhohen dhe në këtë mënyrë ulët kostoja. Kjo është mundësi që mund të rishihet nga ana juaj dhe më pas këto fonde të përdoren diku tjetër, e cila mund të konsiderohet si një gjë e domosdoshme nga ana juaj.

Ermonela Felaj – Pjesa e të dënuarve me kusht është pjesa më e mirë që mund të përdoret për të bërë punë të ndryshme nëpër burgje. Në Bashkinë e Milanos, kryebashkiaku i këtij qyteti shpalli listën e punëve publike ku gjithë të dënuarit me provë zgjedhin se çfarë punë do të bëjnë për komunitetin, si lyerje shkollash, çerdhesh, kopshtesh, mirëmbajtje e lulishteve e të tjera me radhë. Ka ardhur koha që edhe ne t'i adoptojmë këto koncepte që duken moderne, por, në fakt janë të thjeshta, sepse brenda ka kapacitete dhe ne fare mirë mund t'i mbulojmë në këtë mënyrë, por kjo gjë kërkon bashkëpunim.

Stefan Çipa – Realisht kështu është, sepse ne nëpër burgje e realizojmë punën e mirëmbajtjes me të dënuarit që janë aty edhe në bazë të legjislacionit. Po ju them diçka. Tek Instituti i të Miturve, të cilët marrin një profesion kur janë atje, pasi ky është qëllimi, siç e tha edhe zoti Braho, rehabilitimi dhe më pas riintegrimi në shoqëri i tyre, pra, tek Instituti i të Miturve, te

JOP-ja e Beratit e me radhë, ne bëjmë aktivitete të tilla dhe mirëmbajtjen e këtyre institucioneve e realizojmë me këto fonde.

Ju falënderoj për mbështetjen që po i jepni sistemit të burgjeve, por do t'ju thosha se paralelisht me shtetin është krijuar edhe burgu. Sa më i fortë të jetë shteti, aq më i fortë duhet të jetë edhe sistemi penitenciar.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Çipa, si dhe gjithë kolegëve tuaj!

Punë të mbarë!

Do të vijojmë me Gardën e Republikës.

Faleminderit, zoti Komandant i Gardës!

Siç e kishim njoftuar, si pikë të dytë të rendit të ditës, kemi seancën dëgjimore me Gardën e Republikës, lidhur me nevojat buxhetore të vitit që do të pasojë dhe për të kuptuar nëse janë në përputhje me planet tuaja të funksionimit.

Për të folur rreth këtyre gjërave kemi thirrur zotin Gramoz Sako, Gjeneral dhe Komandant i Gardës, zotin Astrit Osmani, Kolonel dhe Shef i Sektorit të Financës dhe Buxhetit, dhe zotin Hysen Minxhozi, Kolonel dhe Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse në Gardën e Republikës.

Faleminderit dhe mirë se keni ardhur!

Ndërkohë, kemi edhe dy përfaqësues nga Ministria e Financave për të mbajtur shënimet e tyre dhe për të vënë në dijeni paraprakisht institucionin e Ministrisë së Financave për kërkesat e institucioneve dhe argumenteve përkatëse.

Fjalën do t'ia kaloj menjëherë zotit Sako, për nevojat buxhetore të institucionit që drejton, i cili në gjykimin e anëtarëve të këtij komisioni, është një institucion i rëndësishëm. Kjo është edhe arsyeja që në vitin e dytë të kësaj legjislature, u thërrasim sërish në këtë komision.

Gramoz Sako – Të nderuar anëtarë të komisionit,

Me këtë rast më lejoni t'ju shpreh konsideratat tona të larta dhe njëkohësisht të relatoj paraprakisht lidhur me nevojat buxhetore për Gardën e Republikës për vitin 2019, duke ju lutur për të na mbështetur për zgjidhjen e problemeve në vijim:

Së pari, për trajtimin financiar të punonjësve. Garda e Republikës për periudhën nga viti 2012 deri më sot ka përfituar vetëm dy ngritje page, një ngritje page me VKM-në nr. 462, datë 22.06.2016 dhe një ngritje page me VKM-në nr. 179, datë 08.08.2017.

Këto dy ngritje page, të marra së bashku shkojnë në një ngritje totale 7,5 % për nivelin e lartë, 11,5 % për nivelin e mesëm dhe 15% për nivelin e ulët. Pra, ngritja e pagës në vlerë për këto struktura, në 6 vjet është 666 lekë në vit për nivelin e ulët dhe 10 mijë lekë për nivelin e mesëm dhe atë të lartë.

Nuk dëshiroj në asnjë rast të bëj paralelizma me struktura të tjera, por është e vetmja strukturë me paga shumë të ulëta, që nuk përfitoi rritje page në vitin 2013, vit në të cilin përfituan ngritje page e gjithë administrata shtetërore.

Problemi tjetër, që lidhet me trajtimin financiar, ka të bëjë me ligjin aktual të Gardës së Republikës, nr. 8869, datë 22.05.2003, ligj i cili nuk e parashikon trajtimin me shtesë page për vjetërsi të kësaj strukture.

Me projektligjin e ri që kemi paraqitur nga ana jonë, janë eliminuar këto dy mangësi. Varet nga mundësia financiare e buxhetit të shtetit për ta mbështetur këtë strukturë me fonde.

Efekti financiar për elementin vjetërsi pune është 95 milionë lekë në vit, ndërsa efekti financiar për të njëhsuar pagat e Gardës së Republikës me ato të Policisë së Shtetit është 150 milionë lekë në vit.

Së dyti, për investime, duke filluar nga viti 2014, mbështetja me investime e Gardës së Republikës ka qenë e kënaqshme. Për dijeni, dy vjetët e fundit, në vitin 2017 kemi marrë 167 milionë lekë, ose 1,5 milionë dollarë amerikanë dhe për vitin 2018 kemi marrë 160 milionë lekë, ose 1,4 milionë dollarë amerikanë. Me këto fonde kemi përmirësuar ndjeshëm inventarin e mjeteve të transportit, armatimin, ndërlidhjen deri te sigurimi i pajisjeve shumë speciale, siç janë: pajisje të bllokimit të valëve celulare dhe pajisja antidron, gjithashtu pajisje të përdorimit të përditshëm për strukturën tonë.

Me VKM-në nr. 406, datë 04.07.2018 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Brendshme te Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkisë së Tiranës, pjesë e pronës së emërtuar “Garda e Republikës, Garnizon””, ndërkohë që strukturat e Gardës së Republikës aktualisht janë të akomoduara në garnizon, të cilat përbëjnë edhe 65% të efektivit, nuk është marrë asnjë lloj vendimi për sistemimin dhe akomodimin e tyre.

Në këto kushte, është e domosdoshmëri mbështetja me fondet e nevojshme për realizimin e investimeve të infrastrukturës si ato të parashikuara në vitin 2019, që janë: ndërtim magazinash, oficinë mjeteve dhe parking për strukturat që do të akomodohen në pjesën e Pallatit të Brigadave.

Rikonstruksioni i plotë i ndërtesave të ambienteve të jashtme e të brendshme në Qendrën e Formimit të Kualifikimit Profesional në Mullet, vlera e të cilës shkon 250 milionë lekë. Sistemimi dhe asfaltimi i sheshit të rrugëve lidhëse, parkim mjetesh me vlerë 110 milionë lekë.

Së treti, për trajtimin me ushqim. Nga janari i vitit 2014, punonjësit oficerë nuk trajtohen me ushqim pa pagesë, sipas vendimit nr. 702, datë 21.08.2013 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Gardës së Republikës, të punonjësve të Policisë së Shtetit, studentëve dhe kursantëve në shkollat e Policisë së Shtetit dhe shtetasve të ndaluar për sqarimin e pozitës së tyre”. Ka shfuqizuar aktet normative mbi bazën e të cilit bëhej ky trajtim.

Sqarojmë se kemi kërkuar disa herë trajtimin me ushqim duke iniciuar një VKM të përbashkët me Policinë e Shtetit, por në mars të vitit 2017 ka dalë VKM-ja “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit”, duke mos përfshirë punonjësit e Gardës së Republikës.

Në këto kushte, kemi në proces miratimin e projektvendimit “Për trajtimin me ushqim pa pagesë të punonjësve dhe kursantëve të Gardës së Republikës” dhe, së fundi, në qershor të vitit 2018, por deri tani nuk ka gjetur miratim, sqarojmë në të gjitha rastet se përballimi me ushqim i strukturave tona, bëhet brenda tavaneve të miratuara për Gardën e Republikës. Në 10 vjetët e fundit, Garda e Republikës e ka realizuar buxhetin që ka pasur në masën 99%.

Këto ishin disa probleme që lidhen me nevojat buxhetore të Gardës së Republikës.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Ermonela Felaj – Ju faleminderit, zoti Sako, për materialin që i keni vënë në dispozicion Komisionit të Sigurisë!

Natyrisht, të gjitha këto shqetësime nuk i gjejmë të reja, për faktin që kemi qenë pranë strukturës suaj dhe kemi biseduar edhe më parë rreth tyre. Nuk është se kemi ngelur pas dhe nuk kemi bërë përpjekje për ta bërë më të vëmendshme Ministrinë e Brendshme apo edhe Ministrinë e Financave, që disa nevoja të punonjësve të Gardës të mund të realizohen, sepse, normalisht, edhe ata kanë vështirësitë e tyre të punës, barrën, shoqërojnë 24 orë në 24 personalitetet më të rëndësishme të vendit dhe, njëkohësisht, ruajnë edhe objektet e rëndësishme të lartë.

Kështu që, jam e bindur që sapo ta hap diskutimin, të gjithë kolegët do të jenë në mbrojtje të kërkesave tuaja. Me punonjësit e Gardës kemi të bëjmë çdo ditë, i kemi para syve çdo ditë, dhe në njëfarë mënyre, do të ishte e papranueshme edhe moralisht që ta nxjerrim jashtë vëmendjes punën që ata bëjnë.

Fjalën do t'ua kaloj kolegëve. Cili do të donte ta merrte fjalën? Zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare! Faleminderit, zoti Drejtor!

Në fakt, Garda, sikurse thatë, është një institucion që ka një rëndësi të veçantë që duhet mbështetur për sa i përket trajtimit financiar. Ndoshta problemet që mund të kenë lidhje me trajtimin financiar dhe që kanë lidhje edhe me ligjin aktual, mund të tejkalohen. Sikurse thuhet në relacion, ligji nuk e parashikon trajtimin me shtesë page për vjetërsi pune, por nga ana tjetër ka nevojë për interpretim të nenit 34 të ligjit aktual.

Më vjen shumë mirë që projektligji i ri i ka tejkaluar këto probleme apo mangësi dhe mendoj se komisioni ynë duhet ta mbështesë kërkesën që vjen nga institucioni i Gardës, për sa i përket pjesës së pagave, aq më tepër që flitet për një efekt financiar për njëhsimin e pagave të Gardës së Republikës dhe Policisë së Shtetit.

Ne mbështetëm edhe në dëgjesën e mëparshme pjesën që kishte të bënte me pagat e Policisë së Burgjeve me nevojën që edhe ato të njëhsohen me policinë, dhe jo më pastaj, Garda dhe Policia, që kanë lidhjen dhe diferencat jo shumë të mëdha qoftë edhe sa u përket kërkesave që vijnë me shkollimin e tyre.

Nga ana tjetër, kisha një pyetje, duke ju mbështetur qoftë për pjesën e investimit apo trajtimin ushqimor, që u ngritën si çështje, me aq sa kemi dëgjuar, Garda do të lëvizë nga institucioni ku ndodhet. A shoqërohet lëvizja juaj në një godinë të re me buxhet shtesë dhe a janë të pasqyruara këto?

Gramoz Sako – Ne e kemi ditur lëvizjen që kur është folur për herë të parë nga zëvendëskryeministri në atë kohë, zoti Peleshi, dhe u kemi paraprirë gjërave. Kemi bërë disa shtesa, ndërtim zyrash atje ku ndodhemi tani, te Pallati i Brigadave, kemi rikonstruktuar të gjitha godinat që kemi pasur, të cilat aktualisht janë në gjendje të mirë për pritjen e pjesës tjetër të gardës, që do të kalojë aty.

Ne kërkojmë mbështetje për qendrën tonë të stërvitjes, që për momentin është në gjendje të rrënuar. Po të ishte e mundur që të mbështetej nga buxheti i shtetit kjo shtesë që kemi kërkuar për riparimin e qendrës stërvitore, do të akomodojmë atje disa forca, do të na ndihmonte shumë në shpërnguljen tonë prej atje. Deri tani nuk është llogaritur ndonjë fond për shpërnguljen e gardës nga një territor në tjetrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

250 milionë.

Ermonela Felaj – Zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, kryetare!

Dëgjova me vëmendje Komandantin dhe jam plotësisht dakord me çdo kërkesë tuajën për atë institucion tepër të rëndësishëm sa i përket pjesës së ruajtjes së personaliteteve dhe më gjerë.

Shpeshherë kemi biseduar edhe më parë në Komisionin e Sigurisë, do të doja të kishim të pranishëm sot edhe një përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, për një ligj të ri për Gardën e Republikës. Ligji i mëparshëm mendoj se është shumë i vjetër për t'u përdorur ende, dhe do të ishte shumë me interes, sepse ministri i Brendshëm, të paktën në disa biseda që kemi pasur, qoftë edhe formale, është shprehur që jemi duke e përgatitur këtë projektligj.

Për sa i përket buxhetit, jam plotësisht dakord dhe do të keni patjetër mbështetjen e komisionit, ndërkohë, ju e thatë pak a shumë se do të shpërnguleni nga godina e vjetër e gardës, por nuk u qartësova. Patjetër që aty keni pasur efektivë të gardës dhe kjo lloj shpërngulje ka patjetër një kosto buxheti për ju. A është parashikuar kjo në këtë buxhet apo jo? Edhe kjo është shumë e rëndësishme.

Faleminderit!

Gramoz Sako –Në buxhet nuk është parashikuar lëvizja. Ndërtimi i magazinave dhe parku na është dhënë dhe janë parashikuar në këtë buxhet, ndërsa Qendra e Formimit, asfaltimi i rrugëve lidhëse dhe parkingu i mjeteve nuk janë parashikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet fjalë për 260 milionë lekë të rinj.

Ermonela Felaj – Pra, magazina dhe parku ju është dhënë për këtë vit te Pallati i Brigadave?

Gramoz Sako – Aty ku e kemi aktualisht, kemi pasur disa blindazhe të vjetra që janë parashikuar për kohë lufte, të cilat do të përshtaten...

Ermonela Felaj – Pra, 260 milionë lekë ju parashikoni për rrugët lidhëse?

Gramoz Sako –Jo, 10 milionë lekë të rinj parashikohen për rrugët lidhëse dhe parkingun dhe pjesa tjetër për qendrën e stërvitjes, që mund të buxhetohet edhe pjesë-pjesë.

(Diskutim pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ka draft, apo nuk ka? Kjo është pyetja e drejtpërdrejtë.

Gramoz Sako –Vitin e kaluar projektligji që kishim paraqitur shkoi deri në qeveri, u kthye mbrapsht për ta ripunuar, e kemi ripunuar dhe aktualisht është te specialistët e Zyrës Juridike

në Ministrinë e Brendshme. Pothuajse është i përfunduar si draft dhe tani pritet mendimi i tyre, ndoshta i Ministrisë së Financave...

(Diskutim pa mikrofon)

Ka efekt financiar dhe kjo është edhe arsyeja që Financat e kthejnë gjithmonë mbrapsht.

Elona Gjebrea – Në fakt, ne i detyrohemi Gardës së Republikës, e tha edhe Komandanti se te pjesa e pagave, kur filloi e u mbështet policia fillimisht, Garda e Republikës nuk përfitoi, kështu që kjo gjë duhet parë me prioritet.

Vetëm te pjesa e VKM-së për ushqimin nuk jam shumë e qartë. Cila ka qenë arsyeja që Garda e Republikës nuk është përfshirë? Unë nuk e shikoj me vend këtë.

Gramoz Sako –Gardës, Policisë dhe Ushtrisë ushqimi iu hoq në vitin 2013. Qeveria “Berisha”, në atë kohë nxori një vendim dhe u hoqi ushqimin këtyre tri institucioneve. Policia bëri një VKM, në të cilin ne nuk u përfshimë, u shfuqizua edhe VKM-ja aktuale. Pra, ne jemi të papërfshirë.

Ermonela Felaj - Më lejo Elona ta sqarojmë këtë gjë!

Ju keni thënë se deri tani e keni bërë vetë trajtimin me ushqim. Mos ndoshta ju ka penalizuar kjo, se ndoshta është menduar që ju i keni kapacitetet për ta bërë vetë dhe për këtë arsye, nuk jua japin ekstra.

Gramos Sako - Ne themi se brenda tavaneve buxhetore që kemi, të na e japin me VKM të drejtën që të trajtohem pa efekte financiare. Deri tani nuk jemi trajtuar. Që nga janari i vitit 2014, ne nuk jemi trajtuar.

Ermonela Felaj – Pra, punonjësit e Gardës ushqehen me lekët e tyre?

Gramos Sako - Ata hanë byrek.

Ermonela Felaj - Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti komandant i Gardës për prezantimin e problematikave që ju keni konstatuar në bazë të planit, që Ministria e Brendshme ju ka dhënë për buxhetin e vitit 2018!

Në vijim të trajtimit ushqimor, unë doja të dija nga ana juaj, nëse ka ndonjë përgjigje nga Ministria e Brendshme në lidhje me normën e trajtimit ushqimor për personelin e Gardës. Në kushtet kur ju keni mundësi ta përballoni normën e trajtimit ushqimor për personelin e Gardës me tavanet buxhetore, nuk ka arsye pse të mos bëhet ky ndryshim. Mbase duhet pak vullnet që kjo siç është miratuar për personelin e Policisë së Shtetit, të miratohet edhe për personelin e Gardës.

E dyta, buxheti i planifikuar për Gardën e Republikës, që i është dërguar nga Ministria e Brendshme është i njëjtë, apo është në ato nivele që ka qenë me realizmin e pritshëm të vitit 2018? A mendoni se ky buxhet i akorduar për Gardën e Republikës përveç pjesës së kërkesave që ju keni për investimet për Qendrën e Formimit dhe Kualifikimit Personal, si dhe të sistemit të asfaltimit të shesheve dhe rrugëve lidhëse për parkimin e mjeteve si rezultat i transferimit të Gardës së Republikës, e realizon misionin e tuaj?

Gramos Sako - Nuk është se nuk realizohet misioni. Misioni edhe në kushte më të vështira realizohet, por do të ishte favorizuese për njerëzit tanë, për oficerët dhe për nënoficerët tanë, që t'u krijoheshin kushte të përshtatshme për stërvitjen apo edhe për trajtimin e tyre.

Halli i parkimit është se makinat që ne kemi në përdorim që shoqërojnë delegacionet më të larta që vijnë në vendin tonë dhe patjetër, duhen kushte shumë të mira parkimi apo lavazhe për të gjitha mjetet që dalin në qarkullim dhe që duhet të jenë të kuruara. Ne nuk mund të themi se kemi pasur mbështetje në këto vite për blerjen e makinave të reja. Armatimin e kemi ndryshuar dhe janë rregulluar shumë gjëra. Tani po kërkojmë një shtesë fondi, nëse do të jetë e mundur nga buxheti i shtetit që të trajtohem për t'i zgjidhur këto probleme dhe për të pasur një strukturë dinjitoze, siç janë edhe homologët tanë.

Ermonela Felaj - Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Në fakt, meqenëse ju keni një marrëdhënie me bashkinë e Tiranës, unë do t'ju rekomandoja që për pjesën e sistemit, të asfaltimit të sheshit dhe të rrugëve lidhëse, si dhe të parkimit të bashkëpunonit me bashkinë në mënyrë që të angazhohej ndërmarrja e mirëmbajtjes së bashkisë, që të kemi një kosto më të ulët dhe patjetër, të kemi një interes të shtuar në drejtim të Gardës së Republikës, patjetër edhe në interes të atyre njerëzve, që punojnë në institucionin tuaj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Dhima!

Urdhëroni, zoti Braho!

Spartak Braho - Unë do t'ju ngacmoj pak, gjeneral. Kush jua ka dhënë titullin "Gjeneral"? Sipas cilit ligj e keni marrë titullin?

Gramos Sako – E kam marrë në bazë të ligjit aktual, që funksionon në Gardën e Republikës.

Spartak Braho – Domethënë, ju nuk keni asnjë lloj varësie nga Ministria e Brendshme. Unë e njoh shumë mirë problemin tuaj. Historia e Gardës ka pasur një problematikë shumë të madhe. Unë prej vitesh nuk kam qenë dakord që Garda të varej nga Ministria e Brendshme. Kështu është në shumë vende të botës. Ne kemi gjetur një të mesme. U bë një artificë, një ndryshim në ligj gjatë kohës që qe ministër, zoti Tahiri. Kjo është arsyeja pse Garda ka mbetur si e njerëz dhe nuk ka atë trajtim që duhet të ketë, megjithëse e meriton. Në fjalën tuaj ju thatë: “oficerët dhe nënoficerët tanë”. Ku i merrni ju oficerët? Nga i merrni? Ju nuk keni as shkollë. Oficerët e policisë që vijnë aty, nuk kanë atë kulturë që të kryejnë detyrat e gardistit apo të shërbimit të Gardës. Garda ka shumë probleme. Shikoni me kujdes ligjin!

Unë do të bëj lobing sa të më eci, që ju si strukturë të vareni nga diku tjetër. E kemi një pengesë kushtetuese, sepse kemi përcaktuar në Kushtetutë që te FA-ja hyjnë Forcat Ajrore, Forcat Detare, Forcat Tokësore dhe nuk mund të krijojmë një forcë tjetër pa e ndryshuar Kushtetutën, siç mund të ishte Garda e Republikës. Ka pasur një ide që ta quanim xhandarmëri etj. Megjithatë, duhet ta zgjidhim. Bëni kujdes shumë për ligjin, për rekrutimet e reja që po bëni tani, sepse i keni të pakualifikuar! Ju nuk keni mundësi kualifikimi. Kështu, këta duhet të ndihmohen me sa të kemi mundësi, zonja kryetare. Ky është mendimi im.

Ermonela Felaj – Shumë e drejtë, zoti Braho!

Në fakt, ne kemi folur edhe më herët me gjeneralin, që është e nevojshme që trajtimi të bëhet me ligj. Ju e dini shumë mirë së bashku me ne, se kur u miratua ligji për Policinë e Shtetit, u tha se kjo pjesë do të bëhej më vonë. Në fakt koha ka kaluar dhe ende nuk kemi një ligj që ta sistemojë aty ku duhet Gardën. Sot për shumë djem, sepse ata janë më të prirur për t’u punësuar në Gardë, mbetet i paqartë informacioni se si rekrutohen aktualisht njerëzit në Gardën e Republikës.

Gramos Sako – Përgjithësisht, deri tani burimi kryesor i efektivëve tanë oficerë, vijnë nga ushtria. Rekrutohen në Gardë oficerët e ushtrisë apo ata që kanë mbaruar shkollën ushtarake. Tani me vënien në funksionim të akademisë së Sigurisë, rreth 400 efektivë tanë e kanë mbaruar kursin tek Akademia e Sigurisë. Domethënë, me vënien në funksion të Akademisë së Sigurisë, kanë filluar të kualifikohen dhe të marrin kulturë policore, juridike të përgjithshme në këtë akademi dhe kualifikimi i tyre po vazhdon. Aktualisht, kemi një kurs që po vazhdon atje. Edhe në vitin që vjen do të vazhdojmë t’i trajnojmë tek Akademia e Sigurisë. Kursi zgjat 2 muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk mësojnë koburen atje. Atë e mësojnë te kursi 3-mujor, që zhvillohet te qendra jonë e stërvitjes.

Ermonela Felaj – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Desha të di, si është arsyetuar mosdhënia e vjetërsisë në punë për punonjësit e Gardës? Pse nuk u është njohur vjetërsia në punë punonjësve të Gardës?

Astrit Osmani – Ligji nr. 8869, datë 22.05.2003 që është në fuqi për Gardën e Republikës së Shqipërisë, te neni 34, parashikon: “Paga e punonjësit të Gardës caktohet në varësi të rolit dhe të gradës që ka fituar, funksionit që kryen, shkallës së rrezikshmërisë dhe vështirësisë, si dhe në varësi të kushteve të tjera, të veçanta, të vendit të punës, të shërbimit dhe të profesionit.” Pra, nuk ka shtesë për vjetërsi në punë. Disa herë kemi tentuar, por DAP-i na ka thënë se nuk e kemi në ligjin organik këtë.

Ermonela Felaj – Prandaj ju nuk e keni marrë asnjëherë vjetërsinë. Duam të fokusohemi për të parë se çfarë mund të zgjidhim ne së bashku me Komisionin e Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ky qenka problemi i ligjit, ndërsa problemi i trajtimit me ushqim më duket se është e zgjidhshme, ashtu siç duhet të zgjidhet edhe problemi i qendrës stërvitore së bashku me rrugët lidhëse. Ne e kemi parë se në çfarë gjendjeje janë ato.

Desha t’ju drejtoj një pyetje. U fol për nevojën për t’u mbështetur për vjetërsinë, për qendrën e stërvitjes dhe për nevojën për t’ju mbështetur me trajtim ushqimor. Po nevojën për psikolog, a e ka ndjerë Garda e Republikës? Kanë ndodhur disa ngjarje në Gardë, që mendoj se e kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik. Ndoshta, njerëzit aty janë të frustruar se ky nuk është një shërbim që konsiderohet i lehtë. A e keni parë këtë nevojë, për trajtimin me psikolog? Po flasim për moshat e reja, për djemtë e rinj, që hyjnë në Gardë me shpresën për t’u formuar aty dhe si gjithë të tjerët, edhe ata kërkojnë të ndërtojnë një familje, por angazhimi 24 orë në 24 dhe vështirësitë e tjera, patjetër që ndikojnë edhe në anën e tyre psikologjike.

Unë nuk jam psikologe, por të them të drejtën ngjarja e fundit, ku një gardist vrau veten, më ka bërë të mendoj dhe t’i bëj këtë pyetje vetes, sepse nuk kam parë që ju të keni trajtim me psikolog.

Gramos Sako – Është e vërtetë që ne nuk kemi pasur trajtim me psikolog. Tani kemi marrë pedagogë të jashtëm dhe kemi futur disa tema për psikologjinë, për menaxhimin e stresit dhe këto tema po i bëjmë me efektivin drejtues. Këto leksione po i marrin strukturat drejtuese të

Gardës, oficerët. Mendojmë që në strukturën e re të parashikojmë edhe psikologët, që nuk i kemi pasur deri tani. Ngjarjet e fundit na kanë bërë ta mendojmë.

Ermonela Felaj – Nëse do t’i parashikonit, sa psikologë mendoni se do t’ju duheshin për Gardën? A e keni bërë një analizë në këtë drejtim apo nuk jeni thelluar dhe keni thjesht një ide?

Gramos Sako – Të them të drejtën, nuk jemi thelluar, por ne nuk do të kërkojmë shtesë personeli. Brenda personelit që kemi, do të mundohemi të shtojmë psikologët që na duhen për strukturën tonë. Deri tani jemi mjaftuar me leksionet që po marrin strukturat drejtuese, duke marrë shkas edhe nga ngjarjet e fundit.

Ermonela Felaj – Ka pyetje apo diskutime të tjera nga kolegët?

Dakord. Besoj se ne jemi të qartë për gjithçka u tha.

Ju falënderoj shumë për prezencën tuaj dhe për seriozitetin në paraqitjen e kërkesave!

Siç e tha edhe zoti Braho, detyrimi ynë, si Komision i Sigurisë është që të llojmë për gjithçka që është e arsyeshme, e domosdoshme dhe e nevojshme. Kështu, ne nuk do të heqim dorë deri në fund për t’i realizuar kërkesat tuaja.

Ditë të mbarë!

Ligji, siç e thotë zoti Vorbsi, është shumë i rëndësishëm. Duhet të përpiqemi fort, ju në detyrimet tuaja dhe ne në tonat, në mënyrë që ligji të vijë dhe kuadri ligjor të mos datojë më para Kushtetutës së RSH-së. Ligji është i vitit 1993, ndërsa Kushtetutën e kemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, i vitit 2003.

Sidoqoftë, kanë kaluar më shumë se 15 vjet.

Gramos Sako – Është e domosdoshme.

Ermonela Felaj – Pas 15 vjetësh ne duhet ta ndryshojmë.

Faleminderit për durimin!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA